



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 83, datë 30.04.2024

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR HEQJEN E LICENCËS
PËR USHTRIM VEPRIMTARIE TË VLERËSUESIT TË DËMEVE NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, te nenit 228, pika 1, gërma e), të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, te nenit 9, pika 1, gërma h) të rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Z. Ilir Meksi është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin e Bordit nr. 199, datë 26.10.2021 “Për miratimin e ushtrimit të veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime për dëmet shëndetësore”, dhe mban licencën nr. 190, datë 26.10.2021.

Me shkresën nr. 114 prot., datë 15.01.2014, z. Ilir Meksi për arsye të mos ushtrimit të aktivitetit për asnjë ditë prej gjendjes së tij shëndetësore, parashtron se tërhiqet vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime dhe kërkon miratimin e kërkesës për heqjen e licencës si vlerësues dëmsh në sigurime.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Revokimin e licencës nr. 190, datë 26.10.2021, së z. Ilir Meksi, për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime, si rezultat i heqjes dorë vullnetarisht.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI